

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 15875/26

Nr. i fq. / Br. sf - 1 -

Data: / Datum 17.04.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



02Nr. PB 373/26
Datë, 17.04.2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 2 Majit – përvjetorit të masakrës së Studimes, në këtë përbërje:
 - 1.1 znj. Medina Bunjaku, Kryesuese e KO
 - 1.2 z. Gëzim Saraçi, anëtar
 - 1.3 z. Izet Miftari, anëtar
 - 1.4 znj. Vildane Mulaku, anëtare
 - 1.5 znj. Blerina Gela Neziri, anëtare
2. Mbledhjet e këshillit organizativ do t'i thërret dhe kryesoj Kryesuesi i KO.
3. Këshilli organizativ do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për organizim të shënimit në mënyrë sa më solemne të kësaj date të rëndësishme.
4. Kryesuesi i KO do të raportoj te kryetari i komunës për përgatitjet e këtij manifestimi si dhe mbarëvajtjen, pas përfundimit të shënimit të kësaj date.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- QSHQ
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - KOMUNA VUÇITRRI

Nr. / Br 15877/26
- 2 -
Data / Datum 17.04.2026

VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



02Nr. PB 375/26
Më, 17.04.2026

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008, nenin 25 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, Nenin 44 paragr. 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË MEKANIZMIT KOORDINUES LOKAL PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJIMORE

1. Themelohet Mekanizmi Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore Komunën e Vushtrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 z. Ferit Idrizi - Kryetari i Komunës, Kryesues
 - 1.2 z. Lorik Maxhuni, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
 - 1.3 Znj. Naile Kovaçi Bekteshi, Drejtoreshë për Arsim, anëtare
 - 1.4 znj. Violeta Pllana, u.d. Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale, anëtare
 - 1.5 z. Ramiz Bunjaku, Udhëheqës i Shërbimeve Sociale, anëtar
 - 1.6 znj. Remzije Zekolli, Zyrtare për Barazi Gjimore, anëtare
 - 1.7 znj. Naile Xhaka, Drejtoreshë e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, anëtare
 - 1.8 z. Berat Maxhuni, Zyrtar për Komunitete dhe Kthim, anëtar
 - 1.9 z. Blerim Ibrahim, OJQ, anëtar
2. Në respektim të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, në takimet e Mekanizmit Koordinues Lokal marrin pjesë edhe:
 - 2.1 Mbrojtësi i viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave
 - 2.2 Përfaqësues nga Gjykata
 - 2.3 Përfaqësues nga Prokuria
 - 2.4 Përfaqësues nga Policia
 - 2.5 Përfaqësues nga Agjencia për Ndeihmë Juridike Falas
 - 2.6 Përfaqësues nga Zyra e Punësimit
 - 2.7 Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br 1744/26
Nr. i fq. / Br. sh - 1 -
Data: / Datum 27-04-2026

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



02Nr. BP 427 /26
Më, 27.04 2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 44 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR RIINTEGRIM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR
DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE

1. Themelohet Komisioni për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 znj. Kimete Mehana, Qendra për Punë Sociale, kryesuese e komisionit
 - 1.2 z. Shkelzen Osmani, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar,
 - 1.3 z. Selim Abazi, zyrtar për Arsim, anëtar,
 - 1.4 z. Ekrem Merovci, Koordinator për Kthim dhe Riatdhesim, anëtar
 - 1.5 z. Mentor Jashari, Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.6 z. Isa Latifi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
 - 1.7 z. Ylber Maxhuni, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, anëtar,
 - 1.8 z. Xhavit Mehmeti, Zyrtar për Integritime Evropiane, anëtar,
 - 1.9 znj. Remzije Zekolli, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, anëtare,
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi është organ vendimmarrës i cili shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar të Komunës së Vushtrrisë për përfitim nga skemat e riintegrit. Komisioni gjatë punës së tij do të merr vendime duke i zbatuar dispozitat e nenit 44 paragrafi 4-9 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.
3. Komisioni në fjalë, për punën e tij duhet t'i paraqet raport me shkrim Kryetarit të Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

vendimi i dërgohet

- Anëtarëve të komisionit
- QSHQ
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRAN
02 Nr. / Br 14417/26
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data / Datum 07.04.2026
VUSHTRRI - VUCITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. PB 323/26
Datë, 07.04 2026

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2026 për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës dhe Planin e Veprimit 2022-2024, Kryetari i Komunës me datën 07.04.2026 merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES

1. Themelohet Komiteti Veprues në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 z. **Shpëtim Zhegrova**, Nënkryetar i Komunës - kryesues,
 - 1.2 znj. **Naile Kovaçi Bekteshi**, Drejtor për Arsim - anëtar,
 - 1.3 z. **Lorik Maxhuni**, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - anëtar,
 - 1.4 z. **Drilon Jusufi**, Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - anëtar,
 - 1.5 znj. **Hyrije Uka Hoxha**, Drejtor për Administratë dhe të Drejtat e Njeriut - anëtare,
 - 1.6 znj. **Remzije Zekolli**, Zyrtare për Barazi Gjinore - anëtare,
 - 1.7 z. **Abit Abiti**, Zyrtar Kryesor Financiar - anëtar,
 - 1.8 z. **Berat Maxhuni**, Zyrtar për Komunitete dhe Kthim
 - 1.9 znj. **Vildane Mulaku**, Shoqata "Martirët e Lirisë 1998/99".
 - 1.10 Z. **Isak Hyseni**, Shoqaata "Handikos" në Vushtrri
2. Z. **Ekrem Merovci**, - shërbyes civil, caktohet koordinator i KKV dhe nuk ka të drejtë vote në KKV.
3. Qëllimi i themelimit të Komitetit Komunal Veprues është implementimi i aktiviteteve komunale të përcaktuara në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2026 për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës dhe Planin e Veprimit 2022-2024. Komiteti Komunal Veprues duhet t'i mbaj të paktën 6 takime në vit ose një takim në çdo dy muaj.
4. Takimet e Komitetit ftohen nga kryesuesi i komitetit përmes koordinorit të KKV-së.
5. Mandati i komitetit është i njëjtë me mandatin e qeverisë komunale.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komitetit Veprues
- Ministrisë së Pushtetit Lokal
- QSHQ
- Arkivit

